



PYETJE DHE PËRGJIGJE PËR APLIKANTËT MBI “THIRRJE PËR PROJEKT IDE DHE BASHKËPUNËTORË” NË ZBATIM TË PROGRAMIT ACTIVATE PËR TIRANA KRYEQYTETI EVROPIAN I RINISË 2022

1. Si mund të aplikojmë për thirrjet e hapura në kuadër të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022?

Thirrjet e hapura janë publikuar në faqen zyrtare të Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022 www.tiranaeyc2022.al dhe në to mund të aplikohet duke ndjekur udhëzimet e përshkuara në njoftimet përkatëse:

Thirrje për Projekt Ide: <https://tiranaeyc2022.al/thirrje-per-projekt-ide-ne-kuader-te-tirana-european-youth-capital-2022/>

Thirrje për Bashkëpunëtorë: <https://tiranaeyc2022.al/thirrje-per-bashkepunter-per-projekte-ne-kuader-te-tirana-european-youth-capital-2022/>

Dokumentacioni për cilëndo thirrje duhet të dorëzohet në mënyrë elektronike më email pranë aplikime@krk-teyc2022.al.

2. A pranohen dokumentet elektronike dhe të firmosura në mënyrë dixhitale apo duhen skanime dhe vula në dokumentacionin përkatës?

Jo, dokumentet do të dërgohen në formë elektronike dhe duhet të jene të firmosura nga përfaqësuesi i aplikuesit, vulosura (kur është e mundur, në rastin e organizatave) e mandej të skanuara.

3. Sa është vlera maksimale që mund të aplikojmë si individ dhe a e mbulon vlera e projektit edhe koston e TVSH nëse na duhet të blejmë materiale ndihmëse?

Vlera maksimale që mund të aplikoni si individ është 700,000 leke (të reja). TVSH është e përfshirë.

4. A mund të aplikojnë organizatat ndërkombëtare?

Po, nëse janë të regjistruara në Shqipëri dhe operojnë edhe në bazë të ligjit shqiptar.

5. A është e mundur që një unviersitet privat të aplikojë me një nga qendrat e universitetit por që nuk operojnë si entitet më vete?

www.tiranaeyc2022.al

Universitetet mund të aplikojnë si partnerë. Për sa i përket qendrave të krijuara brenda universiteteve ato mund të aplikojnë si grupe jo formale ose në bashkëpunim me organizata të tjera.

6. Deri në sa propozime mund të paraqesim?

Nuk ka një limit për arsye se thirrja është akomoduese. Në thirrje nuk është përcaktuar nëse një organizatë mund të aplikojë apo jo me shumë se një herë. Duke u nisur nga ky fakt, është menduar që të mos limitohen mundësitë që organizatat mund të sjellin për të aplikuar, por nga ana tjetër ju kujtojmë se parimi i kësaj thirrje është të akomodojë idetë e sa më shumë entiteteve.

7. Nëse përgjigja ndaj pyetjes së mësipërme është “po”, a ka një limit për sa i përket numrit të projekt-ideve për të cilat mund të aplikojë një organizatë dhe a ka një tavan mbi shumën totale të lekëve që mund të marrë një organizatë nga TEYC2022 për zbatimin e disa projekt-ideve?

Nuk ka një limit dhe taveni përcaktohet qartë për secilin projekt, sipas kategorive në thirrje dhe nuk është kumulativ.

8. Në rast bashkë-financimi, kërkohet që të gjitha aktivitetet në kuadër të një projekt-ideje të jenë aktivitete të reja të cilat do të financohen edhe nga donatorë të tjerë përveç TEYC2022/KRK apo projekt-ideja mund të përfshijë aktivitete të parashikuara dhe financuara në një projekt ekzistues – të organizatës të cilat zgjerohen në madhësi dhe pasurohen me aktivitete të tjera të mbështetura nga TEYC2022?

Bashkëfinancimi është i mirëpritur në çdo rast. Idetë e reja janë të mirëpritura, por edhe projektet që organizatat mund t'i kenë të konsoliduara, në rast se demonstron se po zgjerohen dhe nëse shpjegohet lidhja e tyre e drejtpërdrejtë me TEYC 2022 janë të mirëpritura gjithashtu.

9. A ka një përqindje maksimale për vizibilitetin në buxhetin që do të miratohet?

Në rast se projekt-propozimi rezulton i financueshëm dhe do të kontraktohet për implementim, do të diskutohet në vijim çështja e vizibilitetit dhe buxheti i kërkuar në aspektet e komunikimit dhe promovimit.

10. Cili është ndryshimi midis thirrjes së Hapur dhe thirrjes Direkte, kur është fjala për Projekt Propozime nga Organizata të Shoqërisë Civile?

Në thelb nuk ka asnjë ndryshim, pasi aplikimi duhet bërë në të dy rastet. Është diferencuar pasi me thirrje direkte është dashur të theksohen aplikimet e mundshme të organizatave që kanë marrë pjesë në takimet konsultuese gjatë procesit të aplikimit për EYC2022. Me thirrje të hapur nënkuptohen të gjitha aplikimet e mundshme të organizatave që në procesin konsultues për arsye të pacaktuara nuk kanë qenë pjesë e procesit konsultues.

11. Nëse një projekt shtrihet në dy programe të thirrjes, sa ndikon kjo tek përzgjedhja e projektit nga ana teknike?

Nëse një projekt është menduar dhe motivuar se mund të shtrihet në dy programe kjo nuk ndikon në përzgjedhje/vlerësim apo nga ana teknike. Në sajë të projekt idesë që dorëzohet duhet të shpjegohet qartë ndërlidhja e programeve dhe në rast se projekti përzgjidhet për implementin diskutohen në mënyrë programatike hapat e radhës për përcaktimin e programit.

12. Kur parashikohen të jetë data e shpalljes të projekteve fituese?

Brenda Muajit Shkurt 2022.

13. Nëse një organizatë del fituese si dhe kur bëhet kalimi i fondeve?

Lëvrimi i fondeve është ndarë në 3 Transhe: Transhi I, 50% pas firmosjes së kontratës, Transhi II, 40% pas dorëzimit dhe miratimit të raportit afatmesëm dhe Transhi III, 10% pas dorëzimit dhe miratimit të raportit përfundimtar.

14. A mund të parashikohen aktivitete për implementim dhe zbatim jashtë territorit të Tiranës?

Po, mund të aplikojnë gjithë organizatat nga gjithë Shqipëria dhe në mënyrë shumë të preferueshme projekt-idetë mund të shtrihen në gjithë territorin e Shqipërisë, por duhet të arsyetohet dhe ndërlidhet zbatimi i këtyre aktiviteteve me kuadrin e programit të Tirana Kryqyteti Evropian i Rinisë 2022.

15. A duhet të përfundojë projekti në fund të 2022?

Zbatimi i projekteve parashikohet në një periudhë nga 2 deri në 11 mujore që prej kontraktimit, brenda vitit 2022 sipas kuadrit të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022.

16. A lejohet bashkëfinancimi?

Po, lejohet, madje është i këshillueshëm.

17. A ka një limit për koston e burimeve njerëzore që mund të përfshihen në projekt dhe a mundet të jenë disa individë me kontratë pune me kohë të pjesshme?

Totali i kostove për burimet njerëzore dhe kostove administrative nuk duhet të tejkalojë më shumë se 25% të kostove totale të projektit. Po, është e mundur që disa individë të punësohen me kohë të pjesshme, por kjo zgjedhje duhet të arsyetohet duke u bazuar në nevojat e zbatimit të projektit.

18. A hyn në kostot e burimeve njerëzore pagesa e ekspertit?

Jo, pagesa e ekspertit do duhet të jetë pjesë e kostove për zbatimin e aktiviteteve, pasi bëhet fjalë në këtë rast për një kontratë shërbimi dhe jo për kontratë pune.

19. A janë gabimet në buxhet kriter për skualifikimin e projekt-idesë?

Aplikimi, përfshirë buxhetin kërkohen të jenë parë e riparë me kujdes para aplikimit, por nëse në raste të rralla, kur vërehet se Projekt ideja ka një gabim në formën e lë lapsusi në formularin e aplikimit apo në buxhet, do të vlerësohet por nuk do jetë kusht apo kriter skualifikimi. Aplikimet do

të vlerësohen edhe nga ana teknike dhe në rast nevojash do të negocohen dhe rishikohen disa aspekte.

20. Sa projekte mund të rezultojnë fitues në bazë të buxhetit të programit?

Thirrja është akomoduese dhe synon të aprovojë të gjithë projektet e mundshme që plotësojnë kriteret, por kjo do të varet edhe nga cilësia e aplikimit dhe rezultatet e parashikuara në kuadër të programit dhe objektivave për EYC2022.

21. Sa mund të lëvizim brenda linjave të buxhetit? A mbulohen dietat?

Brenda një kategorie të buxhetit është e mundur të lëvizet deri në masën 10% pa kërkuar një aprovim paraprak nga autoriteti kontraktues. Në rastet kur lëvizja është për më tepër se një kategori buxheti dhe tejkalon masën 10% të totalit të buxhetit, duhet bërë kërkesë Autoritetit Kontraktues për aprovim të ndryshimeve të kërkuara.

22. Çfarë nënkupton fjalia se individ i nuk duhet të jetë subjekt i tatueshëm?

Nënkupton të mos paturit të statusit 'Person Fizik me NIPT', regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

23. A përfshihet kërkimi shkencor dhe raportet si initiative individuale apo në grup?

Po, kërkimi shkencor përfshihet në mënyra të ndryshme dhe nuk ka limit. Sigurisht, duhet kontekstualizuar dhe varet nga dinamika e projekt idesë, por potencialisht kërkimi shkencor mund të jetë pjesë e një aplikimi si Individ, Grup Jo formal dhe si Organizatë.

24. Sa raportime financiare kryhen gjatë projektit?

Raportimet financiare shkojnë paralel me raportimet narrative të projekt idesë. Raportohet dy here: raporti afatmesëm, pikërisht në mes të periudhës së projektit dhe raporti përfundimtar, pas përfundimit të projektit.

25. Po personat fizikë si duhet të aplikojnë?

Personat fizikë, pra personat që do duan të aplikojnë përmes statusit të fituar nga regjistrimi në QKB, nuk mund të aplikojnë. Mënyra e vetme është aplikimi si individë/qtyetarë.

26. Si mundet që të rinjtë nga rajoni apo BE të bëhen pjesë?

Aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Shqipëri si OJF, Grup Jo Formal, ose të jenë shtetas shqiptarë apo rezident brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Të rinjtë nga rajoni apo BE mund të marrin pjesë duke qenë pjesë e Grupit Jo Formal ose në rastin e Organizatave të jenë partnerë me aplikuesin.

27. A Ka limit moshe për aplikuesin që është individ? Po partnerët a duhet të përmbushin të njëjtat kriteret?

Limiti i moshës për individët që aplikojnë, pra aplikuesi, është 15-29 vjet. Partnerët e projektit në nivel ekspertize dhe burimesh njerëzore mund të kalojnë limitin e kësaj moshe.

28. Çfarë përfshijmë dhe nënkuptojmë me deklaratën e konfliktit të interesit?

Deklarate e konfliktit të interesit bëhet nga një individ, grup jo formal dhe organizatë ku vete deklarohet se aplikuesi nuk është në konflikt interesi për rastet e parashikuara në thirrje.

29. A kalon fondi në llogarinë personale të menaxherit të projektit dhe a është përgjegjësia e tij për kryerjen e pagesave?

Në rastin e Grupeve Jo Formale fondi kalon në llogarinë e dedikuar të hapur nga përfaqësuesi i Grupit. Rrjedhimisht, nëse nuk është deklaruar një person tjetër që do të ndjekë zbatimin e projektit, është ai/ajo përgjegjës për aspektet administrative dhe financiare të projektit.

30. Sa persona duhen minimalisht për të formuar një grup jo formal?

Ju lutemi t'i referoheni një juristi apo konsulenti ligjor për sa i përket formësimit/krijimit të këtij grupi.

31. Si do të trajtohet pjesa e sigurimeve dhe tatimeve për menaxherin e projektit dhe anëtarët?

Personat e përfshirë në zbatimin e projekt idesë do të duhet të ndjekin të gjitha aspektet ligjore dhe financiare në vend në bazë të organizatës, grupimit apo kategorisë së përfituesit të projektit.

32. Nëse Tirana është baza e projektit por ndërkohë aktivitetet shtrihen edhe në rrethe, a mund të përfshihen kostot e rretheve në buxhet?

Po, kostot e rretheve mund të indikohen dhe përfshihen në buxhet për zbatimin e projekt-idesë.

33. Për aktivitete të tjera private të cilat do të jenë në shërbim të nismës, a do të ketë mundësi lidhje kontrate individuale me KRK apo Bashkinë e Tiranës, apo vetëm ndërmjet thirrjeve të hapura për projekt ide dhe bashkëpunëtorë?

Kontrata lidhet mes Kongresit Rinor Kombëtar, si autoriteti kontraktues dhe përfituesit sipas kategorisë (organizatës, grupit jo formal apo individit) ekskluzivisht në lidhje me zbatimin e projektit për të cilin është aplikuar përmes thirrje për projekt ide.

34. Nëse disa organizata aplikojnë për një nismë të përbashkët si mund të deklarohen në formularin e aplikimit?

Organizata aplikuese deklarohet si e tillë duke indikuar organizatat e tjera si partnere të nismës së përbashkët të ndërmarrë.

35. A Mundet një organizatë të aplikojë me shumë ide ose me shumë partnerë të tjerë të cilat mund të jenë dhe të huaja dhe të gatshme për bashkëfinancim?

Një organizatë mund të aplikojë më shumë se me një ide dhe mund të ketë më shumë se një partner. Për sa i përket bashkëfinancimit mund të ndodhë si opsion, por edhe partnerët që do të bashkë financojnë një aktivitet duhet të paraqesin dokumentacionin e tyre të kërkuar sipas thirrjes.

36. A ka një modul të gatshëm mbi përshkrimin dhe informacionin që duhet të paraqitet?

Titulli i projektit, partnerët, informacion mbi aktivitetet si edhe informacione të tjera të nevojshme duhet të paraqiten në formularin e aplikimit sipas kategorive përkatëse.

37. A ka një tabelë orientuese për tarifën dhe çmimet mesatare?

Nuk ka një tabelë orientuese, por duhet pasur kujdes për të qenë brenda buxhetit të alokuar dhe gjatë fazës negociuese do të ketë hapësira për të qartësuar aspektet financiare.

38. Për sa i përket % që organizata vetë mund të ofrojë, kjo % mund të jetë e përkthyer dhe nga puna e ndonjë eksperti?

Aspektet financiare in-kind dhe in-cash duhet të jenë relevante ndaj thirrjes dhe aktiviteteve të planifikuara për to, dhe më tej do të qartësohen gjatë fazës negociuese.

39. Mund të jenë organizatat ndërkombëtare partnere?

Po, organizatat ndërkombëtare mund të jenë partnere.

40. Aktivitetet mund të realizohen në qarqe të tjera të Shqipërisë?

Po, por ideja duhet të ndërlihet edhe me Bashkinë Tiranë.

41. A Mbështeten organizatat e reja pa eksperience shumë vjecare në menaxhim projektsh?

Po, në thirrje mund të marrin pjesë edhe organizatat e reja dhe në nivel eksperience do të konsiderohet CV e anëtarëve që do të jenë në grupin e punës për zbatimin e projekt idesë.

42. Organizatat e huaja a mund të kryejnë partneritet me organizatat shqiptare si aplikant kryesor?

Po, organizatat e huaja mund të jenë partner me një aplikues të regjistruar në Shqipëri e që përmbush kriteret, por kujtojmë se edhe partnerët duhet të dorëzojnë dokumentet e tyre si aplikuesi. Në rastin e një partneri, organizate të huaj, duhen dorëzuar dokumentet analoge/të ngjashme që nevojiten për të përmbushur kriteret e kërkuara në nivel ligjor e administrativ.

43. Nëse procedura e përzgjedhjes shtyhet a ndikon kjo afatin e zbatimit të projektit?

Në këtë rast, përgjatë fazës negociuese do të rimodelohet dhe përshtatet harku kohor i mundur për implementimin e aktiviteteve prej fillimit deri në Dhjetor 2022.

44. A mund të aplikosh si individ nëse je i përfshirë në projekte me bashkëpunëtorë dhe organizata?

Po është e mundur, por nuk duhet të ketë mbivendosje aktiviteteve.

45. Për të plotësuar formularin që ju keni, duhet futur on-line dhe duhet dërguar po on-line?

Në lidhje me formularin dhe mënyrën e aplikimit faqen web të Tirana European Youth Capital në seksionin "News" gjeni thirrjen për projekt-ide për organizatat. Në fund të kësaj thirrjeje keni një paketë aplikimi që mund të shkarkohet. Është një file zip që sapo e hap dalin të gjithë anekset që duhet të plotësohen. Duhet plotësuar këto file me të dhënat që kërkohen, ashtu sikurse ndodh edhe me projekte të tjera. Pasi të plotësohen duhet edhe të printohen, të firmosen, vulosen, të skanohen dhe më pas të dërgohen me e-mail në adresën e treguar në thirrje. Gjithashtu edhe paketa e dokumentacionit që kërkohet bashkëlidhur formularit të aplikimit dhe buxhetit, duhet të

skanohen dhe të dërgohen në format elektronik bashkë me formularët e aplikimit, të gjitha së bashku me një aplikim të vetëm, me një e-mail të vetëm.

46. Gjatë kohës që ne përgatitemi, në momentin që jam në një projekt që është aktiv dhe aty ne synojmë që të mbjellim edhe një ide për një aktivitet që ka të bëjë me titullin "Tirana European Youth Capital 2022" dhe kemi nevojë për bashkëpunëtor, kryesisht të rinj, kemi nevojë për ata që janë të aftë, qoftë edhe për marketing on-line, për ata që mund të jenë "follow up" në terren, kemi nevojë edhe për një grup. Pyetja është: Si mund ta krijojmë një bashkëpunim ne?

Kur flasim për bashkëpunëtorë, thirrja për bashkëpunëtorë i referohet entiteteve që kanë në këtë moment, ose kanë të planifikuara, projekte apo programe që i kanë të financuara nga burime të tyre dhe dëshirojnë vetëm që të futen brenda kalendarit të aktiviteteve të "Tirana Youth Capital". Pra dëshirojnë që të kenë edhe logon e "Tirana Youth Capital" dhe të përfitojnë nga ndjekësit, të rinjtë, pjesëmarrësit e aktiviteteve që "Tirana Youth Capital 2022" do ketë gjatë vitit. Kur flasim për bashkëpunëtorë, flasim për entitete që dëshirojnë t'i bashkohen programit dhe nuk kërkojnë fonde.

47. Për sa i përket projekteve që janë në vazhdimësi (on-going) a mund të përfitojnë ato nga fondi i "European Youth Capital 2022"?

Do thoja që ato që janë on-going, nuk mund të përfitojnë, por projektet që janë *on-going* mund të kenë një vazhdimësi, një seri të dytë që ka nevojë të shtrohet përmes disa aktiviteteve të ndryshme, për të plotësuar disa rezultate të një programi akoma më të madh. Pra të jetë si një projekt më vete, por që shkon në vijimësi të një projekti tjetër të realizuar. Në këtë rast të dytë, po, mund të përfitohet nga fondi i EYC2022.

48. A ka thirrja një shtrirje në gjithë territorin e Shqipërisë?

Po, thirrja ka shtrirje në gjithë territorin e Shqipërisë dhe projekt-identë që mund të aplikohen nga organizata të cilat janë nga rrethet e tjera të Shqipërisë, duhet të kenë një arsyetim të tyre një lloj lidhjeje me veprimtarinë, me aktivitetet që do zbatohen atje, por edhe brenda territorit administrativ të Bashkisë Tiranë.

49. Jemi një organizatë me përvojë të gjatë në studim dhe politikë-bërje në nivele të ndryshme. Punojmë me të rinjtë dhe gjimnazistë të qyteteve të ndryshme. A kemi ne mundësi të aplikojmë, pavarësisht se fusha e rinisë nuk është e specifikuar në statutin e organizatës, megjithëse ne punojmë me të rinjtë?

Në statut duhet të jetë e shprehur që bëhen nga organizata aktivitete për të rinjtë. Pra thirrja është e hapur për organizatat rinore që do të thotë që në rastin kur organizata ka një bord ku mesatarja e moshës së bordit është brenda mesatares sipas ligjit shqiptar deri në 29 vjeç. Për organizata të tjera që janë për të rinjtë, i referohemi organizatave të tjera që këtë kriter nuk e mbulojnë, por që kanë demonstruar përmes CV-së, përmes një ose më shumë pikave të veprimtarisë së tyre në Statut që parashikojnë aktivitete me të rinjtë dhe për të rinjtë.

50. Jam workshop lider për film-making dhe ky është një projekt që ka nisur nga studentët e mi. Jam në një dilemë të aplikoj me organizatë apo si individ?

Për organizatat e reja për CV-në e tyre ne do bazohemi tek CV-të e personave që do të përbëjnë grupin e punës për zbatimin e projektit. Varet nga dinamikat e projekt idesë nëse dëshiron të aplikosh si individ apo si organizatë, por potencialisht mund të aplikosh në një nga këto dy kategori.

51. Përpos formatit të aplikimit është e mundur të kemi listën e dokumenteve që kërkohen për raportim si dhe formatin e raportimit?

Formati i raportimit nuk jepet në këtë moment. Do i jepet organizatave, entiteteve, pra mund të jenë organizata, grupe jo formale apo individë, në momentin kur bëhet kontrata. Aneksë të kontratës do të jenë edhe këto formularë.

52. Një individ, mund të aplikojë si staf i një organizate, por mund të aplikojë edhe si individ, a mund të jetë njëkohësisht në dy projekte?

Aplikimin e parë e bën organizata, pra nuk ka lidhje me individin. Ndërsa si individ patjetër që po mund të aplikoni.

53. Nëse një OJF mund të aplikojë si aplikues në një projekt, a mund të aplikojë edhe në një projekt tjetër si partnerë?

Po, mund të aplikojë në një projekt si partner dhe në një projekt tjetër sërish si aplikues, pasi nuk ka limite.

54. Sa projekte do financoni në kuadër të kësaj thirrjeje?

Këtë gjë nuk mund ta themi me siguri, sepse varet nga numri i aplikimeve dhe shuma që kërkohet në secilin aplikim. Me fjalë të tjera, kemi një tavan për aplikime që është 7,500,000 Lekë, por nuk kemi një dysheme. Nuk dimë ende sa kërkesa do vijnë. Parimi që do ndiqet është ai i financimit të sa më tepër projekteve të mira dhe cilësore.

55. A mund të jenë partnerë organizata të tjera nga Rajoni dhe Europa?

Po, mund të jenë partnerë.

56. A mund të zbatohet projekti në vende të tjera që nuk është Shqipëria?

Jo, projektet nuk mund të zbatohen në jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, por mundet që disa aktivitete të zbatohen edhe jashtë këtij territori në rastet kur ato aktivitete zbatohen në bazë të resurseve financiare pjesë e një bashkëfinancimi.

57. Në lidhje me pjesën e partnerëve të huaj. Dokumentacioni mbështetës duhet edhe për partnerët apo vetëm për aplikuesin?

Dokumentacioni mbështetës duhet edhe për partnerët, brenda dhe jashtë vendit. Për partnerët jashtë vendit duhet një dokumentacion analog/i ngjashëm, i cili është i mjaftueshëm për të përmbushur kriteret e kërkuara në thirrje.

58. A do të ketë thirrje të dytë për projekt-ide në muajt në vazhdim?

Ne urojmë që të ketë thirrje të dytë, por vendimi do merret pas shqyrtimit të numrit të projekt-ideve të dorëzuara që do të aprovohen dhe që do zbatohen.

59. A mund të aplikojnë shkollat e mesme?

Shkollat publike, private nuk mund të aplikojnë, por mund të gjendet mënyra se si të aplikojnë. Pra, mund të jenë partnerë dhe të jetë një organizatë që ato njohin, me të cilën kanë bashkëpunuar apo duan të ndërtojnë një lloj raporti për të aplikuar në këtë thirrje. Ose me një vendim të drejtorisë mund t'i jepet "ok" një prej mësuesve, që me një grup nxënësish mund të krijojnë një grup jo formal dhe aplikojnë së bashku me një projekt ide që ka të bëjë me përmirësimin apo pasurimin e aktiviteteve brenda shkollës.

60. Për sa i përket limitit të kostove të burimeve njerëzore është 25% vetëm për burimet njerëzore apo bashkë me koston administrative?

Të dy kategoritë, totali i kostove të burimeve njerëzore dhe kostove administrative nuk duhet të kalojë limitin 25% të vlerës totale të projektit.

61. A kërkohet kontribut nga organizata?

Jo nuk kërkohet, por nëse organizata deklaron se ka një bashkëfinancim të brendshëm apo të një donatori tjetër, është e nevojshme ta deklarojë dhe ta shkruajë në projekt-propozim, pasi në nivel komunikimi më pas mund të bëhet problem. Nëse keni një donator tjetër dhe nesër në dijeninë tonë do shfaqet edhe një logo tjetër papritmas, ky është problem.

62. Në rastin e shkollave, a mund të aplikojnë shkollat jashtë Tiranës vetëm për aktivitete në shkollën e tyre apo duhet të lidhen patjetër me një shkollë në Tiranë?

Duhet të ketë një lloj binjakëzimi me një shkollë brenda territorit administrativ të Bashkisë Tiranë.

63. Grupet jo formale që krijohen posaçërisht për këto projekte, a do të jenë të disavantazuara. A duhet të ketë ky grup pune një histori më përpara?

Mund të jetë i krijuar rishtazi, por do ishte mirë që në përmbushjen e një qëllimi, grupi jo formal, kur ka një organikë dhe lind për një arsye të caktuar për përmbushjen e një qëllimi të caktuar, në nivel afatgjatë ose afatshkurtër të ketë një lloj eksperience apo aktiviteti të mëparshëm. Nuk i limitojmë grupet e formuara rishtazi, por duket të dorëzojnë, jo një CV të grupit jo-formal sepse nuk e kanë, por të individëve që e përbëjnë atë grup.

64. Kam një ide e cila tani funksionon si start-up, a mund të aplikoj si grup apo si individ dhe më pas të shtoj anëtarët e grupit?

Nëse është një start-up që funksionon pse duhet të aplikoni? Dhe nëse aplikimi është për të zgjeruar aktivitetin apo për të marrë një rrjedhë tjetër, sepse është identifikuar një nevojë X e cila mund të realizohet përmes një financimi të tillë, atëherë po. Çështja nuk është të ripërsëritim ide që janë zbatuar apo janë funksionale, por të shkojmë përkrah qëllimeve të programeve të "European Youth Capital 2022".

65. A është e këshillueshme që të preken në projekt-ide disa nga programet apo duhet fokusuar vetëm te njëri?

Mirë do ishte që fokusi të ishte tek një program. Por ka projekt-ide që shkojnë në mënyrë të natyrshme dhe prekin programe të ndryshme. Por kam përshtypjen që nuk i prekin asnjëherë në të njëjtën masë. Do i theksoni disa programe, por duhet thënë se te cili program ka fokusin projekt-ideja.

66. Sa me detaj këshillohet që të shkojmë me buxhetin apo është gjithçka e detajuar te paketa?

Te aneksi apo shembulli që është on-line brenda në paketë, është indikativ. Është në radhë të parë për t'ju treguar se do e shtroni buxhetin në nivel aktivitetesh dhe jo në nivel kategorish. Duke përjashtuar kategorinë e parë dhe të dytë që ka të bëjë me shpenzimet administrative dhe stafin. Kurse të tjerat duhet të detajohen sa më shumë të jetë e mundur, për zbatueshmërinë konkrete të projektit.

67. A mund të aplikojnë studentët që nuk kanë eksperiencë të mëparshme të punës vullnetare për të treguar në CV-në e tij, pra që ka kredibilitetin për të zbatuar një nismë të tillë?

Këtu nuk flitet që individët duhet të kenë eksperiencë në punë vullnetare. Nëse kanë eksperiencë duhet t'i rendisin dhe kjo është më mirë, sidomos po të jenë në linjë me projekt-idenë, por është kjo e fundit e cila do të merret parasysh.

68. Drejtuesi i një organizate OJF i cili është i punësuar në një institucion shtetëror, ku Drejtori Ekzekutiv i organizatës OJF është titullar dhe jo koordinator i projektit, a mund te aplikoj?

Drejtori Organizativ i organizatës nuk duhet të jetë punonjës i administratës publike, edhe pse nuk ka një rol aktiv për zbatimin e projektit statusi është përjashtues për këtë thirrje.

69. Në çfarë mënyre mund të aplikojmë si grup jo formal gjimnazi ?

Thirrja përkrah aplikimin e grupeve joformale që mund të organizohen dhe të formohen për të zbatuar projekt ide për të rinjtë brenda gjimnazeve. Kjo gjë do bëhet e mundur nga themelimi i grupeve joformal brenda gjimnazit duhet të përbehet nga student dhe mësues që do të dakordësohen paraprakisht por mesatarja e moshës së grupit joformal duhet të jete nga 15-29 vjeç. Grupi joformal duhet të ketë shume anëtar te rinj dhe mesatarja të jetë brenda grup moshës 29 vjeç

70. A mundet që në buxhet të paraqitet edhe për shembull “ndërtimi i qendrës së rekreacionit në shkollë” si aktivitet?

Po, është pjesë e projekt idesë që ju do paraqisni dhe në saj të projekt idesë behet dhe përcaktimi i buxhetit dhe i zërave të tij.

71. A ka një limit projektesh të cilat do të përzgjidhen nga Kongresi Rinor Kombëtar?

Nuk ka një limit projektesh që do përzgjidhen pasi nuk dihet sa projekte do të paraqiten dhe cili do të jetë buxheti i tyre.

72. Mund të aplikojmë me tepër se 1 herë si individ ose p.sh. : 1 here si individ dhe 1 herë si pjesë e një organizate?

Mund të aplikohet më shume se 1 herë qoftë si grup jo formal qoftë si individ, pasi nuk ka limit.

73. Sa është buxheti maksimal nëse aplikon si grup jo formal dhe si individ ?

Grupet jo formale 1.4 milion lekë (të reja) dhe si individ 700 mijë lekë të reja.

74. Nëse një projekt ide kalon përtej individit duke kaluar në instanca të tjera për tu zbatuar ky projekt, kujt duhet t'i drejtohem ?

Projekt propozimi duhet të jetë i mirë menduar paraprakisht duhet të kryhet komunikimi me institucionet të jenë dakord të nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimi dhe me pas të aplikoni si entitet si individ ose si grupe jo formal, e njëjta gjë vlen edhe për organizatat.

75. Si do te trajtohen individët dhe grupet jo formale në sensin e lidhjes së kontratës dhe financimit?

Modalitetet se si do të trajtohen këto grupe do të kenë të bëjnë ngushtësisht me natyrën e idesë që do të prezantojnë dhe gjithashtu me aspektin negociues që do të bëhet përpara nënshkrimit të kontratës.

76. Krijim i mundësisë për të komunikuar me dikë i cili është përgjegjës për pjesën e shkrimit të projekteve përpara dorëzimit të tyre për strukturimin e ideve

Jo, pasi stafi i Kongresit Rinor Kombëtar në kuadër të Tirana European Youth Capital 2022 pranë nuk ofron konsulencë për shkrimin e ideve.